AKT –THEMELIMI I SHOQËRISË ANONIME
"KLUBI FUTBOLLIT RUBIKU RUBIKU" SH.A

Në Rubik, sot më dt 13.09.2010, Bashkia "Rubik" duke patur parasysh;

Masivitetin e sportit dhe veçanërisht të futbollit në popullatën brenda juridiksionit të saj;

Me qëllim organizimin e sportit të futbollit me themelimin e shoqërisë anonime "Klubi Futbollit Rubiku"Sh.a.;

T'ju afrojë qytetarëve të saj, përsona fizik e juridik mundësin juridike, organizative dhe ekonomike për të kontribuar në zhvillimin e sportit në përgjithësi dhe të futbollit në veçanti;

Synimin e pjesëmarrjes në të gjitha veprimtaritë që organizon Federata Shqiptare e Futbollit (F.SH.F.) si dhe ato të organizmave ndërkombëtare FIFA dhe UEFA për të cilat deklaron se njeh dhe pranon autoritetin e tyre;

Vendimit të këshillit bashkiak Nr. 18, datë13.09.2010 te Bashkis Rubik;

Referencën të ligjit 8184 datë 28.03.1996; ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ligjin NR. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit" vendosi:

Neni 1

Krijimin e shoqërisë tregtare shtetërore e llojit Anonime "Klubi Futbollit Rubiku"Sh.a. Shoqëria është person juridik i të drejtës shqiptare dhe vepron si e tillë në çdo rrethanë. Emri i shoqërisë tregtare është shoqëria tregtare "Klubi Futbollit Rubiku" sh.a. Shoqëria ka selinë e saj në qytetin e Rubik në adresën prane godines se Bashkise Rubik.

Shoqëria ka një kohëzgjatje të veprimtarisëe së saj pa afat të caktuar.

Neni 2

Objekt i veprimtarisë se shoqërisë "Klubi Futbollit Rubiku" sh.a. do të jetë:

Organizimi , drejtimi, financimi dhe administrimi i Klubit të Futbollit Rubik i cili do te quhet "RUBIKU" (K.F.Rubiku), organizimi i aktiviteteve sportive, pjesmarje në aktivitete të organizuara F.SH.F.; Fifa dhe UEFA. Brenda dhe jashte vendit, Import Eksport dhe tregtim të artikujve sportivë.

Neni 3
Organet Drejtuese

Asambleja e aksionarve. (vendimet e aksionarit të vetëm, për sa kohe është i tillë janë të barazvlershem me ato të asambles së aksionerve);

Këshilli Mbikqyres;

Administratori;

Neni 4
Përberja e Organëve Drejtuese

Asambleja e Aksionerve përbëhet nga pjesmarja e aksionarve themelues.

Bashkia Rubik si aksionare e vetme duke qënë se është përson juridik do të përfaqësohet në ketë asamble nga kryetari i saj. Me miratimin e këtij akti themelimi Kryetari i Bashkisë, gëzon të gjitha të drejtat e përfaqësimit në asamble të aksionarve dhe nuk ka nevoj për autorizim tjetër të mevonshem. Kjo e drejtë i njihet dhe në rast se Bashkia nuk do të jetë zotëruese e 100% të aksioneve. (në rast të tjetërsimit të një pjese të aksioneve). Në çdo rast kryetari i bashkisë do të jetë përfaqësues i aksioneve të zotëruara nga Bashkia Rubik. Vendimet e aksionarit të vetëm, për sa kohë është i tillë janë të barazvlershëm me ato të asambles së aksionerve.

Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga një numër i plotëpjestueshëm me tre. Antarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen dhe shkarkohen nga asambleja e aksionerve sipas regullave të këtij akti themelimi si dhe statutit të saj. Këshilli i parë Mbikqyrës do të përbëhet nga tre anëtarë:

Administratori do të jete një përson fizik i i cili zgjidhet per nje mandat 3-vjecar. Ai mund te rizgjidhet me mbarimin e mandatit.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.000.000 lekë dhe do të derdhet si kontribut në para nga aksionari themelues në një llogari bankare të hapur për këtë qëllim mbas rregjistrimit të shoqërisë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 2.000 aksione me vlerë nominale 1 000 lekë/aksion dhe zotërohet 100% nga aksioneri themelues Bashkia Rubik:

Mbas rregjistrimit të shoqërisë pranë QKR, mbi bazën e vendimit të asamblesë së aksionarve kapitali themeltar mund të shtohet si në kontribute në para ashtu dhe nëpërmjet kontributit në natyre duke respektuar ligjin dhe rregullate e këtij statuti.

Neni 6

Ndërtimi organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, rregullohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, në baze të statutit dhe këtij akti themelimi.

Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të nënshkruaj aktet e themelimit të kësaj shoqërie si dhe statusin e saj.

Shoqëria fillon veprimtarinë me nënshkrimin dhe miratimin e dokumentave të saj themelues.

Për aksionarin themelues
Bashkia Rubik
Mark Ruçi

MARK RUÇI

(Kryetar i Bashkisë)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
Nr. 1665 Rep.
Nr. Kol.

VERTETIM – NENSHKRIMI

Sot me date 14 Shtator 2010 (dymije e dhjete), diten e Marte, u paraqit personalisht para meje noterit Ylli Çela, me seli ne Tirane, Rruga "Mine Peza", Pall.3, Ap.25, Shoqeria Anonime "Klubi Futbollit Rubiku"Sh.a., e perfaqesuar ne baze te Vendimit Nr.18, date 13.09.2010, te Keshillit te Bashkise Rubik, nga Kryetari i saj Z.Mark RUÇI, i biri i Gjonit, lindur ne Tarazh-Mirdite me 20.08.1961, banues ne Rubik, madhor, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me Pasaporten Nr.BB3953431, i cili me vullnetin e tij te lire dhe te plote e nenshkroi pa verejtje ne pranine time aktin e mesiperm, te perpiluar jashte kesaj zyre, ndersa une e vertetoj ate sipas ligjit.

NOTER

Ylli ÇELA

PULLE TARIFE 200 LEKE